

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Lamine Yamal zbulon prapaskenat e finales së Botërorit 2026: Ishim të bindur se Argjentina nuk do të shënonte
ADRESA	https://albeu.com/sport/lamine-yamal-zbulon-prapaskenat-e-finales-se-boterorit-2026-ishim-te-bindur-se-argjentina-nuk-do-te-shenonte/1028541/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 14:47:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 14:45:57 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e72ed25b53b5b83dafc4fb5ff335de0f7c46ea1594de510bef6b27255ce76b21
TEKSTI	4326521cb0ca7facbb45a04d819c1c19a3a0ed7601d080670d4bac02133f4f2b
PAMJA	af4ca3ff4fbadff511822b96cf6dc471869fb8770235848451bb6e011b24a9a9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ae437a59b8cce5279d04fd17143f94a114803ac2f27a66f8660d0e24cbb74b72
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c646a932fde53c288233dea515333d4375993381cb212e1a0a5e6c9db33460b4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ae437a59b8cce5279d04fd17143f94a114803ac2f27a66f8660d0e24cbb74b72>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Lamine Yamal zbulon prapaskenat e finales së Botërorit 2026: Ishim të bindur se Argjentina nuk do të shënonte



Lamine Yamal ka treguar detaje nga finalja e Botërorit 2026, në të cilën Spanja mposhti Argjentinën dhe fitoi titullin kampion bote.

Futbollisti i Barcelonës tha se skuadra spanjolle besonte se kundërshtarët nuk do të arrinin të shënonin pas kartonit të kuq të marrë Enzo Fernandez.

"E dinim se ishte e pamundur që ata të shënonin dhe, me topin në këmbët tona ndaj një skuadre me 10 lojtarë, ishte shumë e vështirë që ne të mos shënonim".

Yamal foli gjithashtu për mënyrën se si përpiqet t'i çorientojë mbrojtësit dhe tregoi se të njëjtën qasje e përdori edhe në aksionin që solli golin e Ferran Torresit.

"Një mbrojtës i krahut do të ketë një trajner që i thotë: 'Në rregull, Lamine, ai bën këtë...'. Unë e mendoj atë si një robot që përpiqet të më ndalojë".

"Robotët mund të jenë pothuajse perfektë, por një njeri ka diçka që roboti nuk e ka. Futbolli është mekanizuar, por ka lojtarë si unë, Pedri dhe shumë të tjerë që kanë atë shkëndijën e veçantë".

Futbollisti spanjoll pranoi se një prej burimeve të frymëzimit të tij është Neymar, veçanërisht për mënyrën se si braziliani kryen disa lëvizje.

"Është një lëvizje tipike e Neymarit kur ndalet, bën sikur do të shkojë në një drejtim dhe pastaj shkon në tjetrin. Kam parë shumë video të tij. Përpiqem të luaj me kundërshtarët, që ata të mos mund të më mekanizojnë dhe të mos e dinë se ku do të shkoj".

të fundit /



Modeli statistikor projekton Shqipërinë si fituese të grupit dhe...



Lamine Yamal zbulon prapaskenat e finales së Botërorit 2026: Ish...



Zjarri në varrezën e makinave mbulon Tetovën me tym,...



FSK-ja dhe Ushtria Turke mbajnë stërvitje të përbashkët për...



Ardon Jashari: Zvicra ka qenë gjithmonë zgjedhja ime e vetme



"Në OKB foli për Diellën, jo për Thaçin", Mediu kritikon Ramë...



Fitorja ndaj Irlandës e ngjiti Kosovën në renditjen e FIFA-s



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Yamal kujtoi se në finale pati tri përballje me mbrojtësin e krahut të Argjentinës, ndërsa Alexis Mac Allister i afrohej vazhdimisht për t'i ardhur në ndihmë.

"Më kujtohen tri aksione në minutat 60, 70 dhe 80, përafërsisht, kur e provova mbrojtësin e krahut. Çdo herë, Mac Allister vinte për ta ndihmuar".

"Po të doja vërtet të shkoja kundër mbrojtësit, do të kisha shpejtuar. Por këtë herë shkova më ngadalë, duke e mbajtur topin, në mënyrë që Mac Allister të kishte kohë të vinte, Pedro Porro të arrinte pas meje dhe unë ta ktheja topin".

Ky aksion u shndërrua më pas në asistin për golin vendimtar të Ferran Torresit.

"E dinim se Ferrani kishte nevojë për të. Në fakt, të gjithë kanë nevojë për një gol në një finale të Botërorit. Edhe nëse Unai Simon do të kishte shënuar, do të ishte mirë".

"Kur topi futet në rrjetë, është spektakolare. E ndien se je kampion bote. Nuk mund ta shpjegosh atë emocion".

Yamal nënvizoi se në minutat e fundit të takimit nuk e kishte menduar se Argjentina mund të gjente golin e barazimit.

"Gjithçka që doja ishte të vazhdoja të luaja. Nuk mendova kurrë: 'Mund të barazojnë'. Kishte një shtytje të vogël, një rast që Pau Cubarsi e largoi, por unë po e shijoja ndeshjen".

Shtuar më 26.09.2026 16:45

Tags: kombëtarja e spanjës , lamine yamal , përfaqësuesja e argjentinës



Modeli statistikor projekton Shqipërinë si fituese të grupit dhe ngjitetë në Lig...



Ardon Jashari: Zvicra ka qenë gjithmonë zgjedhja ime e vetme



Fitorja ndaj Irlandës e ngjit Kosovën në renditjen e FIFA-s



Kriza përshkallëzohet në Irlandë, Gavin Bazunu nuk dëshiron të luajë ndaj...



Policia austriake forcon sigurinë para sfidës me Kosovën, vendosen mas...



Irlanda anulon paraqitjen mediatike para ndeshjes me Izraelin, shtohen...



Erbilin Osmani shkruan historinë me Kosovën, debutimi i 17-vjeçarit...



Zidane rikthen Mbappen në krah, ylli francez i pakënaqur me rolin e ri

albeu

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.